



Lajmëtari i Radio Marisë

Tetor 2011

Viti III, Nr. 10

Në këtë numër do të lexoni

- Tre ditë ripërtëritje shpirtërore në Shëngjin me vullnetarët e programit të Radio Marisë 3
- I Lumi Papa Gjon Pali II dhe Virgjëra Mari (p. 5) 4

Lajmëtari i Radio Marisë është organ i Shoqatës Radio Maria.

Tiranë

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 4

Fushë Kërçik

Babrru, Paskuqan

Tiranë, Shqipëri

+355 4 2 346 346

Shkodër

Sheshi Papa Gjon Pali II

Shkodër, Shqipëri

+355 22 24 08 52

E-mail

info@alb.radiomaria.org

Përgjegjës

Don Prekë Lazraj

Radio Maria,

**Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde,
mund të dëgjohet në:**

Rrëshen e rrethina

FM 100.7 MHz

Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat

FM 91.4 MHz

Shkodër, Podgoricë, Ulqin

FM 102.2 MHz

Lezhë, Laç të Kurbinit, Mamurras

FM 89.6 MHz;

Pukë, Fushë Arrëz, Tropojë,

Kukës dhe Kosovë

FM 90.0 MHz

www.radiomaria.al

TETORI MUAJI E ZOJËS RRUZARE

Vatikan, më 7 tetor 2011

Fort të dashur Meshtarë e Diakonë,

Përkujtimi i përvitshëm liturgjik i Zojës Rruzare ngjall disa reflektime që dua t'i ndaj bashkë me ju. Shihet dukshëm, e së fundmi Dita Botërore e Rinisë në Madrid e ka provuar, se Rruzarja e shenjtë është "kthyer në modë", "sërisht në vendin e vet" – do të ishte më mirë të thuhej -, dhe pra në duart e besimtarëve, të rinj e më pak të rinj, shekullar e të kushtuar.

Një prej dhuratave të shumta që i Lumi Papa Gjon Pali II ia ka bërë krejt Kishës është pikërisht kjo: rivendosja e Rruzares së shenjtë në duart e të gjithëve. Me shembullin e vet, Papa i Lumë, ka motivuar dhe ka confirmuar veprimin e atyre që nuk e kanë braktisur kurrë këtë praktikë urtie, edhe në kohët kur mund të të tallnin apo të të gjykonin për këtë; dhe i ka dhënë mrekullueshëm arsyet kristologjike dhe ekleziologjike, përveç atyre mariane dhe shpirtërore, që janë në themel të kësaj lutjeje të mrekullueshme që i ka rrënjët e veta në misterin e shëlbimit.

Në Letrën Apostolike *Rosarium Virginis Mariae* lexojmë: "Rruzarja e V. Mari [...] është lutja e dashur nga shumë shenjtër dhe e përnxitur nga Magjisteri. Në thjeshtësinë dhe thellësinë e saj, ajo mbetet [...] një lutje e një domethënieje të madhe, e përcaktuar të sjellë fryte shenjtërie. [...] Është lutje nga zemra kristologjike. Në kthjelltësinë e elementeve të saj, ajo përqendron në vetvete thellësinë e krejt porosisë ungujllore". (RVM n. 1)

Në fakt, Rruzarja e shenjtë, mbi të gjitha në jetën e mbarështuesve të shuguruar, është një ndihmë e jashtëzakonshme për të jetuar me qëndrueshmëri të zhytur në misterin e Krishtit, pothuajse "duke e risjellë" vazhdimisht jetën, fjalët, shembullin, sjelljet dhe duke favorizuar maksimalisht, edhe në këtë mënyrë, atë njësojshmëri me Krishtin, aq të nevojshme në ushtrimin besnik të mbarështimit.

Rruzarja e shenjtë na bën të jetojmë gjithmonë në kujtimin e Krishtit! Me këtë lutje sublime e të thjeshtë, mund ta kujtojmë Krishtin me Marinë, ta mësojmë Krishtin nga Maria, t'i përshtatemi Krishtit me Marinë, ta kërkojmë dhe ta shpallim Krishtin me Marinë!

Kjo lutje e ëmbël pushimi na afron

paqësisht në mënyrë unike me popullin e shenjtë të Hyjit, me të thjeshtët e me të ngriturit, me shenjtërit e me mëkatarët. Nuk ka lutje që ka nevojë për më pak përgatitje dhe që, njëkohësisht, të jetë aq e efektshme për zemrën dhe mendjen e njeriut.

Rruzarja e shenjtë, pohon shërbëtori i Hyjit Papa Pali VI, "jo vetëm që nuk del kundër Liturgjisë së Kishës, por edhe e mbështet atë, tashmë që e paraqet dhe i bën jehonë mirë, duke u angazhuar për ta jetuar atë me plotësinë e pjesëmarrjes së brendshme, duke ia mbledhur frytet në jetën e përditshme" (RVM n. 4).

Të dashur Meshtarë dhe Diakonë, le t'ia besojmë vazhdimisht mbarështimin dhe ecjen tonë personale të shenjtërimit së Lumes Mari Virgjër, edhe përmes lutjes së përditshme dhe të palodhshme, besnike dhe të përvuajtur të Rruzares së shenjtë. Në histori nuk na mungon shembulli i shenjtërve dhe papëve, që ishin edhe "më të mbytur me punë" se ne. Nuk ka lutje tjetër që mund ta përballojë me efektshmëri të përvuajtur dhe "të mishëruar" çdo punë ungujllëzimi të vërtetë si kjo.

Më të fortët do ta zbulojnë se Rruzarja e shenjtë na bën të përvuajtur dhe të vetëdijshëm se duhet të jemi vegla në duart e Zotit; më të dobët do të gjejnë aty fuqinë dhe mbështetjen, guximin dhe strehimin. Të gjithë do ta shohin mbarështimin e vet të lulëzojë dhe të sjellë fryt, pasi, me Marinë, shikimi i gjithkujt shndërrohet dalë-ngadalë, duke u afësuar për ta njohur "Jesusin që po kalon" në çdo njeri dhe rrethanë.

Edhe unë e lus për çdo ditë Rruzaren e shenjtë për të gjithë klerikët në botë dhe, përvuajtërisht, lutem që ecja e shenjtërimit dhe e reformimit të Klerit të ndodhë si vepër e Shpirtit dhe fryt i amësisë së ëmbël të Zojës së Rruzares. Ju uroj mbarësi në muajin e tetorit të gjithë juve që me lutjen e Rruzares së shenjtë që na bashkon, si kokrrat e kurorës, në një dashuri të fortë vëllazërore sakramentore mes nesh dhe me Pjetrin!

Maurus Card. Sincera

Prefekt i Kongregatës për Klerin

TRE DITË RIPËRTËRITJE SHPIRTËRORE NË SHËNGJIN ME VULLNETARËT E PROGRAMIT TË RADIO MARISË.

Këtu po ju sjellim përshtypjet e disa prej vullnetarëve për këtë ripërtëritje shpirtërore.

Në datat 16-18 shtator, Radio Maria organizoi një ripërtëritje shpirtërore për vullnetarët e programeve në bregdetin e bukur të Shëngjinit. Kjo ripërtëritje u drejtua nga Don Preka, Drejtori i radios. E falënderoj Zotin nga zemra që na e bëri një dhuratë kaq të çmueshme e kaq shumë të dobishme për secilin nga ne në fillimin e këtij viti të ri shkollor. Kështu forcohem edhe më shumë në besim dhe virtyte.

Në këto tre ditë të ripërtëritjes u përqendruam në njohjen edhe më të mirë të misionit tonë si të krishterë dhe në punën tonë në radio. Mësuam shumë gjëra, por më së shumti u ndalëm në kapitullin e parë të Ungjillit sipas Markut. Ajo çfarë ka ndikuar më shumë në mua ka qenë fjalja kur Hyji thotë: *“Ti je im Bir, djali i dëshirit, ty të miratova”*. Ky është edhe çasti kur Jezusi ndërmerr publikisht misionin e vendosur nga Ati për Shëlbimin e njerëzve.

Gjithashtu, Don Preka na mësoi dhe na vendosi në mënyrë praktike se si duhet ta lexojmë dhe meditojmë Shkrimin e shenjtë. Kjo më ka ndihmuar shumë që ta lexoj Fjalën e Zotit për çdo ditë dhe të mundohem që ta jetoj atë gjatë ditës praktikisht. Kështu të mos e pres një çast më vonë, por t'ia jap Fjalës së Zotit një vend të rëndësishëm në fillimin e ditës, në mënyrë që ajo të më drejtojë gjatë gjithë ditës në vazhdim.

E kemi jetuar secilën ditë më bukur se tjetrën, më të gjallëruar se tjetrën, më të gëzuar se tjetrën, e me më shumë fe. Mund ta quaj këtë udhëtim një mrekulli që ka lënë mbresa të jashtëzakonshme tek unë. Bashkimi ka shumë rëndësi, sepse po të jemi të bashkuar, çdo gjë është më e bukur, më e dashur. Edhe Jezusi ka thënë: ‘Nëse dy ose tre janë të bashkuar në Emrin tim, atëherë Unë jam në mesin e tyre’.

Një gjë tjetër që mund ta theksoj e që më ka ndihmuar gjatë këtyre ditëve ka qenë ndihma që i kemi dhënë njeri-tjetrit me buzëqeshje, gëzim e bashkëndarje në punët e ndryshme si në kuzhinë, pastrim e shërbime të tjera të nevojshme, në të cilat ishte i përfshirë secili prej nesh. Buzëqeshjet e të gjithëve, dashuria mes nesh, bashkëndarja, të gjitha këto i kanë karakterizuar këto tre ditë të mrekullueshme.

Qëllimi i këtyre ditëve ishte që të gjithë ne të përtëriheshim dhe të ktheheshim njerëz të rinj, të mbushur me dëshirën për të ndryshuar duke punuar çdo ditë me vetveten, të mbushur me virtyte e duke lënë pas çdo ves. Unë personalisht e vërej një ndryshim të tillë tek vetja ime dhe besoj se edhe të gjithë të tjerët që ishin pjesë e kësaj përvoje e kanë përjetuar një ndryshim të tillë në veten e tyre.

Faleminderit, Jezus, që na e mundësove ta përjetonim një përvojë kaq të paharrueshme.

Brikena



Ishte data 16 shtator 2011. Pasdite u nisëm të shkonim në Shëngjin për një ripërtëritje shpirtërore të gjithë ne vullnetarët e programit të Radio Marisë. Kur mbërritëm në vend, u vendosëm nëpër dhoma e pastaj u ulëm të gjithë poshtë që të bisedonim së bashku me Don Prekën për qëllimin e kësaj ripërtëritjeje. Këtu e kuptuam se do të kishte kohë për lutje dhe kohë edhe për zbavitjeje. Për sa i përket çasteve të lutjes, kemi folur për fenë. Çfarë është feja? Kuptuam se feja është zbulesa që na e bën Zoti. Gjithashtu diskutuam edhe se si e kanë zbuluar nxënësit Jezusin. Nxënësit e kanë zbuluar Jezusin me vështirësi të madhe si Shëlbues dhe Zotëri.

Medituam një pjesë nga kapitulli I i Ungjillit sipas Markut. Është një pjesë që të lë të kuptosh shumë gjëra mbi Zotin. Këtu Don Preka na tha diçka shumë të bukur: *“Sa herë ta lexojmë Fjalën e Zotit, duhet të kuptojmë diçka të re”*.

Ditën tjetër medituam mbi pjesën e Ungjillit që flet për pagëzimin e Jezusit. Këtu kuptuam se me anë të pagëzimit hyjmë në tokën e premtuar. Pagëzimi i vërtetë bëhet kur e pranoj vetë në jetën time dhe e bëj atë jetën time. Kjo ripërtëritje shpirtërore ishte shumë e veçantë dhe e paharrueshme. Ishte një bashkëbisedim me Zotin që na e ripërtëriu shpirtin.

Përsa i përket çasteve zbavitëse, edhe ato kishin veçantinë e tyre. Ishim grup i formuar prej moshave të ndryshme, por kishim një bashkëpunim të rrallë. Ishim si një familje e madhe dhe e lumtur. Çastet kur laheshim në det apo kur luanim volejball ishin shumë të bukura. Gjithçka ishte e mrekullueshme, e paharrueshme dhe shumë e veçantë. Arritëm të bashkëbisedonim me Zotin dhe të njiheshim më mirë me njëri-tjetrin.

Paola dhe Antonio

Fillimi i të premtes së 16 shtatorit ishte monoton, por e nisa me një entuziazëm të veçantë duke e ditur se çfarë më priste më tej. Pas disa orëve të gjata mësimi, që dukeshin sikur nuk kishin të mbaruar, më në fund ra zilja që më solli ndërmend se duhej edhe shumë pak për t'u nisur në ripërtëritje shpirtërore. Nxitova për në shtëpi, përgatita gjërat e fundit që kishin mbetur dhe isha gati. Së bashku me disa të afërm u nisëm për në mjediset e Radio Marisë. Pas pak çastesh mbërritën edhe të tjerët e ishim të gjithë bashkë.

Në fytyrën e secilit vërehej një ndriçim i veçantë, jo i zakonshëm, i njëjtë me ndriçimin e fytyrës sime. E gjithë kjo kënaqësi nuk ishte e kotë, pasi e dinim se çfarë mrekullie na priste. Të gjithë e dinim se në njëfarë mënyre shkëputja nga gjërat e përditshme, të mërzitshme, shpeshherë të padrejta, të bukura ose të kënaqshme, por jo aq sa ta plotësonin jetën tonë, nuk ishte e vështirë. Madje, përkundrazi, ishte e bukur, shumë e bukur. Duke e ditur se do ta linim realitetin tonë pas krahëve (vetëm për pak ditë), dhe atë për një arsye më të fortë se vetë realiteti, gëzimi shtohet edhe më shumë, pasi do të bashkoheshim me Jezusin, në saje të të cilit edhe e kemi jetën.

Pa dashur të përmend çdo hollësi të rrugës, arritja në Shëngjin ishte një pjesë më vete. Vetë vendi ku ne gjendeshim ishte i



përsosur për ta bërë edhe më të fortë kuptimin e fjalës "ripërtëritje shpirtërore". Ishte një vend i qetë e tejet i mirë për të medituar, për ta pastruar shpirtin tonë, e për t'u ndjerë të qetë, të patrazuar.

Gjatë atyre 3 ditëve patëm kohë të mjaftueshme, por jo aq sa do të dëshironim, për t'u njohur me Jezusin, e për të kuptuar atë që Ai do për ne, për të mirën tonë. Nën udhëzimet e Don Prekës, patëm mundësinë ta shohim veten se ku jemi e të shohim se çfarë duhet të bëjmë për të arritur më pranë Hyjit.

Një ndër gjërat që mua më është ngulitur thellë në mendje është "fillimi i botës së re me Jezusin!", i një bote në të cilën jam unë dhe Jezusi, asgjë tjetër, pasi asgjë tjetër nuk duhet të ketë më shumë rëndësi për mua sesa Jezusi. Ai është Zoti i jetës time dhe duhet që t'ia jap vendin që i takon me çdo gjë që bëj e në çdo ditë të jetës time.

Na ndodh shumë shpesh, që në disa situata nuk dimë si të veprojmë. Nuk dimë se si ta dallojmë të mirën nga e keqja. Don Preka na mësoi gjatë ripërtëritjes shpirtërore që në të tilla raste duhet që gjithmonë ta pyesim Jezusin: "Jezus çfarë të bëj?".

Përpos gjërave të mësuara, një moment i veçantë çdo mbrëmje ka qenë lutja e Rruzares së shenjtë së bashku, e cila na bashkoi edhe më shumë të gjithëve me njëri-tjetrin. Pa diskutim do të thosha se gjatë kësaj fundjave kemi qenë si një familje e madhe e mbledhur në gjirin e Hyjit. Në këtë vatër familjare të krijuar, as problemet e vogla, as dashakeqësia, as smira e asgjë e keqe nuk mund të ndërhyjnë në bashkimin tonë, sepse ishim të lidhur fort me njëri-tjetrin. Në mes nesh mbizotëronte paqja, dashuria, harmonia, gëzimi, lumturia, entuziazmi, që vetëm Hyji di t'i dhurojë. Është vërtet bukur ta zbulosh se jemi bij e bija të Hyjit dhe se Ai është Ati ynë që kujdeset për çdo gjë të mirë në jetën tonë.



Për këtë arsye, dua ta falënderoj Hyjin për çdo çast të kaluar gjatë këtyre ditëve dhe t'i kërkoj forcën që të më ndihmojë ta shndërroj në një fundjavë si ajo çdo ditë dhe çdo çast të jetës sime, e cila nuk do të kishte asnjë vlerë po të mos ishte e jetuar me Hyjin, Atin tim.

I LUMI PAPA GJON PALI II DHE VIRGJËRA MARI

Ky është një shkrim i punuar nga Imzot Juan Miguel Ferrer Grenesche, Nënsekratr i kongregatës për kultin Hyjnor dhe disiplinën e sakramenteve, të cilin do ta sjellim me pjesë në disa numra të Lajmëtarit.

...vazhdon nga numri i kaluar

Nuk ka mundësi të përfundojë një studim për Papën Gjonin Palin II dhe Virgjërën Mari pa e përmendur aspak atentatin e 13 majit të vitit 1981, që e bashkoi në mënyrë përfundimtare këtë Papë me Zojën e Bekuar, dhe në mënyrë të veçantë me Fatiman dhe mesazhin që lidhet me këtë Shenjtërore dhe shfaqjet që filluan këtu. Një botim më i ri i Akademisë Teologjike Papnore (María Theotokos, Editrice Vaticana 2011) ia kushtoi një kapitull të tërë «Papës Gjonit Palit II dhe sekretit të Fatimas», në të cilin çështja trajtohet arsyeshëm dhe gjerësisht.

Lidhur me këtë ngjarje, e gjejmë shpjegimin e «sekretit të tretë» të Fatimas, aq të dashur për Gjon Palin II, që u realizua më rastin e lumturimit të Jacintës dhe Françeskut, më 13 maj të vitit 2000, me tekstin e interpretimit autentik të «sekretit» që lexoi sekretari i shtetit, Kardinali Sodano. Vetë Papa Gjoni Pali II, e ndjente se jeta dhe pontifikati i tij ishin të lidhur me këtë «mesazh» duke përdorur të gjitha mjetet në jetën baritore të Kishës në zbatimin e mbarështimit të Pjetrit, duke dëshiruar nxitjen e kthimit dhe shenjtërimin të sa më shumë njerëzve, siç tha Kardinali Sodano: «Arsyeja e ardhjes së Tij (e Atit të shenjtë) në Fatima është lumturimi i dy barinjve. Ai, prapëseprapë, dëshiron që këtij shtegtimi ti japë vlerën e një gjesti të ripërtërirë të falënderimit ndaj Marisë që e mbrojti gjatë këtyre viteve të pontifikatit. Kjo është një mbrojtje që duket se prek edhe të ashtuquajturin “sekretin e tretë” të Fatimas». Në vitin 1983, Papa iu dërgoi të gjithë ipeshkviëve një formulë të kushtimit, së bashku me ftesën që t'i bashkohen kushtimit që kishte në program ta bënte në Romë, me rastin e të Kremtes së Të Shëlbuarit në vitin 1984, viti i shëlbimit, në mënyrë analoge me atë që tashmë kishte bërë në Fatima në maj të vitit 1982.

Përfundimi

Nuk mund të mos e përfundoj këtë paraqitje timen për Gjonin Palin II dhe Marinë e ta lë pa përmendur bariun e madh, i cili më shumë se tre shekuj më parë e shënoi historinë e popullit spanjoll: Shën Ildefonsin nga Toledo.

Bariu xheloz që, më ndihmën e Virgjërës, ia doli të shërojë plagët e fundit të arianizmit të popullit visigot, duke u kthyer në Gotin e parë katolik që do të merrte përsipër detyrën e arqipeshkvit të Toledos. Zemra e tij ishte e Marisë, siç tregon Traktati i tij *Për Virgjërinë e amshueshme Shën Marinë*; jeta e tij ishte e lidhur thellësisht me Krishtin që nga pagëzimi, siç tregon *Komenti për kuptimin e Pagëzimit*; qëllimi i tij ishte që ta përshkonte shkretëtirën e kësaj jete si një bredhës, për të udhëtuar deri në atdheun e përjetshëm, siç dëshmon në Traktatin *mbi përparimin në shkretëtirën shpirtërore*.

Edhe Ildefonsi përjetoj, gjatë jetës së tij, ndërmjetësimin e gatshëm amnor të Marisë dhe i besoi plotësisht mbrojtjes së saj, siç tregojnë në traditën e përshtirshme për përjashtimin që ia bëri Shenjtit Virgjëra Mari. Ildefonsi në Spanjë, Gjoni Pali II në Poloni dhe në pjesën tjetër të botës, ishin Barinj të Marisë, pra të Krishtit. Po e mbyll këtë punë me lutjen e Shën Ildefonsit, që gjendet në pjesën e fundit të Traktatit *“Për Virgjërinë e amshueshme Shën Marinë”*, lutje që e pashë Gjon Palin II duke e lutur:

«M'i jep të gjitha këto, o Jezus, Hyji dhe Biri i njeriut;
 m'i jep këto, o Zot i gjithësisë dhe Biri i shërbëtores sate;
 zgjeroji këto, o Hyj që u bërë i përvuajtur kur pranove natyrën njerëzore,
 më lejo, o Njeri që lavdishëm u bashkove me Hyjin,
 që unë të besoj rreth lindjes së Virgjërës
 sa herë që më duhet ta plotësoj fenë time rreth mishërimit;
 më jep që të flas rreth virgjërisë së Nënës Sate
 sa herë që duhet që goja ime t'i kumtojë lavdet e tua;
 bëj që unë ta dua Nënë Tënde
 sa herë që duhet të arrij në vetvete plotësimin e dashurisë sate;
 Bëj që unë t'i shërbej Nënës Sate
 në mënyrë që unë të tregoj se të shërbeva Ty;
 bëj që ajo të më mbajë në shërbimin e saj
 në mënyrë që kushti të jetë se të kam pëlqyer Ty;
 bëj që zotërimi i saj të më ruajë në këtë jetë tokësore
 derisa Ti të bëhesh Zotëria im për tërë amshimin».

PRO CREDIT BANK

LLOGARIA NË EURO 600388970102

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 45209516090000600388970102

LLOGARIA NË LEK 600388970001

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 56209516090000600388970001

INTESA SAN PAOLO BANK

LLOGARIA NË EURO 1043631803

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 2520811008000001043631803

LLOGARIA NË LEK 1043631801

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 7920811008000001043631801

NË ZVICËR ME 5 FRANGA

Duke telefonuar në numrin:

0900123411

Në bankën CREDIT SUISSE

RADIO MARIA

LLOGARIA NË CHF 361173-10-1

IBAN: CH1804835036117310001